

Përshëndetje,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informim të datës 20.06.2024, regjistruar në datën 21.06.2024, ju bëjmë me dije se, kjo kërkesë është regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve 2024 të DAP-it, me numrin rendor 19, sipas detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 119/2014 "*Për të Drejtën e Informimit*", të ndryshuar. Për çdo kërkesë tjetër për informim ju mund t'i drejtoheni adresës së kontaktit info@dap.gov.al.

Lidhur me pyetjen tuaj nëse një nëpunës civil mund të zgjidhet dhe të ushtrojë mandatin e anëtarit të Këshillit Bashkiak, ju bëjmë dije si vijon:

Një nëpunës civil që kandidon në zgjedhjet e përgjithshme apo lokale, qoftë si kandidat për Kryetar Bashkie, qoftë për Këshilltar Bashkiak, ka detyrimin që të parashtrojë kërkesën për pezullim pranë njësisë së burimeve njerëzore ku ushtron funksionin si nëpunës civil, apo pranë DAP, në rastin kur është nëpunës civil i Nivelit të Lartë Drejtues.

Pezullimi në rastin e kandidimit në zgjedhje buron nga pika e 3, e nenit 37, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, ku parashikohet se: "*Nëpunësi civil ka të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore.*"

Në këtë rast, nëpunësi detyrohet të kërkojë pezullimin nga detyra, si dhe nga shkronja "d", e pikës 1, të nenit 54, të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar, që disiplinon se: "*1. Nëpunësi civil pezullohet nga shërbimi civil në këto raste: d) regjistrohet, sipas ligjit, si kandidat për zgjedhjet vendore apo politike, për periudhën nga regjistrimi deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar apo deri në përfundim të mandatit.*"

Pezullimi në këto raste zgjat nga momenti i kandidimit deri në përfundim të mandatit si i zgjedhur, kur nëpunësi civil zgjidhet Kryetar Bashkie, deputet apo këshilltar bashkiak dhe deri në momentin e shpalljes së rezultateve përfundimtare me vendim të autoriteteve zgjedhore.

Sa i takon pyetjes, nëse z. G. A. është emëruar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë Rajonale Fier, nga të dhënat që ne disponojmë rezulton se z. A. ka mbajtur pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Shërbimeve Laboratorike në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Fier.

Sa i takon pyetjes, nëse z. K. T. është emëruar në pozicionin e Drejtorit në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, nga të dhënat që ne disponojmë rezulton se z. T. është emëruar në këtë pozicion me aktin nr. 6088/3 datë 08.11.2017.

Për sa i përket kërkesës suaj për t'ju vënë në dispozicion aktet e emërimit, të nëpunësve të sipërcituar, ju bëjmë me dije se në nenin 14, të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, përcaktohet se:

"1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarës:
a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta; b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.

4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar."

Për sa më sipër, DAP ju ka informuar për aktet e kërkuara, por është në kushtet e pamundësisë për t'ua vënë në dispozicion këtë informacion në formën e kërkuar, pra duke përcjellë kopjet e akteve të emërimit, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 17, të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, titullarët e të drejtës nuk kanë dhënë pëlqimin për përcjelljen e akteve të tyre individuale të emërimit.

Lidhur me pyetjet tuaja për pjesëmarrjen e mundshme të këtyre nëpunësve në një Komision Disiplinor, ju sqarojmë se përbërja e Komisionit Disiplinor në institucionet e administratës shtetërore është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe shteruese në pikën 2, të Kreut I, të VKM-së nr. 115/2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, të ndryshuar:

“2. Komisioni disiplinor, për institucionet e administratës shtetërore, përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka këtë përbërje:

a) nëpunësin më të lartë civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore, i cili kryeson komisionin;

b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

c) drejtuesin e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit ku bën pjesë nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;

ç) një përfaqësues të DAP-it;

d) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.”

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

Departamenti i Administratës Publike